



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



ARRU/UTSH/USH – 08/04-08/2015

31. 05. 2016

Në pajtim me autoritetin e dhënë me nenin 19.2 të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të datës 30 Janar 2016 ("Ligji").

Konform Nenit 15. të Rregullës për Përcaktim të Tarifave të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë të datës 24 Dhjetor 2012 (Rregulla ZRRUK R-02/U&K),

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifa Shërbimi të ujit të trajtuar me shumicë të KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë për procesin tariforë 2015-2017, qëndrueshmërinë financiare dhe analizave të të dhënave të realizuara të performancës së saj për furnizim të ujit të trajtuar me shumicë te Veriut të Qytetit të Mitrovicë, lëvizjeve inflatore në vend të periudhës Dhjetor 2014 – Nëntor/2015 dhe rrethanave socio ekonomike në vend.

Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit (ARRU) lëshon këtë:

URDHËRESË PËR TARIFA SHËRBIMI

PËRCAKTIM I TARIFAVE PËR FURNIZIM TË UJIT TE TRAJTUAR ME SHUMICË PËR APLIKIM NGA KRU "MITROVICA" SH. A. MITROVICE PER FURNIZIM TE VERIUT TE QYTETIT TE MITROVICËS, GJATE PERIUDHES TARIFORE 01. 06. – 31. 12. 2016 NGA PROCESI TARIFORE 2015-2017

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit (UTSH), përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që u atribuohen Rregullës ZRRUK R-02/U&K.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifës së Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për aplikim nga KRU "MITROVICA" Sh. A. Mitrovicë, të cilës i kërkohet të aplikoj tarifën e shërbimit sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit me rastin e faturimit të Ujit me Shumicë të Trajtuar për Pjesën Veriore të Qytetit të Mitrovicës.

3. Lista e Tarifave të Shërbimit

Gjatë vitit tariforë 2016 të periudhës së procesit rregullatorë të tarifave 2015 - 2017, KRU "MITROVICA" Sh. A., Mitrovicë, do të furnizojë pjesën Veriore të Qytetit të Mitrovicës me ujë të trajtuar me shumicë me tarifën e përcaktuar sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit, kolona 5.

Tabela 1. Tarifa e procesit rregullatorë për aplikim gjatë vitit 2015, nga procesi rregullatorë 2015-2017

Nr.	Përshkrimi i shërbimit me ujë	Njësia matëse	Tarifa historike e vitit 2014	Tarifa e aplikueshme për faturim gjatë vitit 2015	Tarifa e aplikueshme për faturim nga 01.06-31.12.2016
1	2	3	4	5	6
1	Ujë me shumicë i trajtuar	€/m ³	0.16	0.17	0.17

Tarifa e aplikuar është pa TVSH.

4. Aplikimi i tarifës

Tarifa e Shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të trajtuar e aprovuar sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit do të aplikohet;

Nga: 01. 06 gjerë me 31. 12. 2016.

5. Procedurat e rishikimit të tarifës

Tarifat e aplikuar për vitet 2016 dhe 2017 mund të rishikohen për përcaktim dhe aplikim gjatë vlefshmërisë së tarifave të këtij procesi rregullatorë të periudhës së mbetur 3 vjeçare 2015-2017, në përputhje me aktet rregullative të ARRU-së, duke marr në konsideratë performancën e KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë, shkallen e lëvizjeve inflatore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Kosovë, publikuar nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës për vitin 2016 nga periudha inflatore dhjetor/2014 – nëntor/2015, dhe për vitin 2017 për periudha inflatore dhjetor/2015 – nëntor/2016 dhe rrethanave socio ekonomike në vend

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifës së Shërbimit

KRU "MITROVICA" Sh. A., Mitrovicë është e obliguar të njoftojë marrësin e Shërbimit të Ujit të Trajtuar me Shumicë, me tarifën e aprovuar sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit dhe të bëjë nënshkrimin e Kontratës për këtë shërbim me te dhe së paku një herë me faturën e parë të ngarkesës tarifore sipas kësaj UTSH-je ti bashkëngjis të njëjtën faturës me të cilën informohet marrësi i shërbimeve.

6. Apelet

KRU "MITROVICA" Sh. A., ka të drejtë të apelojë këtë urdhëresë ose pjesë të saja brenda një muaj, nga data e publikimit, tek Komisioni Shqyrtues i themeluar konform nenit 41.1, Komisioni Shqyrtues, Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të datës 30 Janar 2016.

7. Gjuha Zyrtare e Urdhëresës së Tarifave

Kjo Urdhëresë e Tarifave nxjerrët dhe publikohet në tri (3) versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë:

- 1) Shqip,
- 2) Serbisht, dhe eventualisht në
- 3) Gjuhen Angleze.

- 2) Serbisht, dhe eventualisht në
- 3) Gjuhen Angleze.

Në rast të mospërputhjeve në mes të versioneve, do të mbizotërojë versioni i Gjuhës Shqipe.

